

VENDIM
Nr.36, datë 26.9.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE
“ATLANTIK” SHA PËR VITIN 2004

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenet 93 dhe 111 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të ligjit “Për kontabilitetin”, pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. T’i kërkohet shoqërisë së sigurimeve ATLANTIK sh.a. të krijojë rezervën e sigurisë në shumën 12 042 603 lekë që përbën 1/3 (një të tretën) e fitimit të vitit ushtrimor 2004.

2. Shoqëria e sigurimeve ATLANTIK sh.a. të bëjë provigjonimin për shumën e debitorëve në vlerë totale 9 579 635 lekë.

3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi të pasqyrohen nga shoqëria e sigurimeve ATLANTIK sh.a. në pasqyrat financiare deri në 31.12.2005.

4. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve ATLANTIK sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba